V E N D I M
Nr.531, datë 24.9.2001

PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS DHE TË EMBLEMËS SË SHËRBIMIT DOGANOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e uniformës dhe të emblemës së shërbimit doganor, sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin në zbatim të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i kushtëzuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Ministri i Financave të miratojë "Rregulloren e uniformës së shërbimit doganor".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

ANEKSI I
PËRBËRJA DHE NORAMTIVA VJETORE E UNIFORMËS SË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Nr.	Emërtimi	Njësia	Personeli doganor (meshkuj)	Personeli doganor (femra)	Personeli i Antikontrabandës
1	Xhaketë (ngjyrë blu)	Copë	1 (një)	1 (një)	-
2	Xhakavento (ngjyrë blu)	Copë	-	-	1 (një)
3	Pantallona dimërore (ngjyrë gri)	Palë	2 (dy)	1 (një)	2 (dy)
4	Pantallona verore trikoton (gri)	Palë	2 (dy)	1 (një)	2 (dy)
5	Fund dimëror (ngjyrë gri)	Copë	-	2 (dy)	-
6	Fund veror (ngjyrë gri)	Copë	-	2 (dy)	-
7	Këmishë verore (ngjyrë gri)	Copë	3 (tre)	3 (tre)	3 (tre)
8	Këmishë dimërore (ngjyrë gri)	Copë	3(tre)	3 (tre)	3 (tre)
9	Kollare (ngjyrë blu)	Copë	2 (dy)	2 (dy)	2 (dy)
10	Pulover me jakë "V" me supanjë dhe me stof tek bryli (gri)	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
11	Xhup impermeabel (blu)	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
12	Rrip mesi lëkure (i zi)	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
13	Bustinë me strehë stofi (blu)	Copë	2 (dy)	2 (dy)	2 (një)
14	Këpucë verore (të zeza)	Palë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
15	Këpucë me qafa (të zeza)	Palë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
16	Stemë krahu e plotë	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)

UNIFORME VERORE



UNIFORME DOGANIERI

UNIFORME ANTIKONTRABANDE



ANEKSI II

EMBLEMA E SHERBIMIT DOGANOR SHQIPTAR